



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	20.11.2020	24.11.2020	Nr.916/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.11.2020, OE - “KCS TRADE L.L.C & TPK OROMETAL” Graçanicë ka parashtruar ankesën me nr.916/20, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbyesve të nxehtësisë 2 dhe 3 ” me nr. te prok. KEK-20-776-511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 1.000.000,00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të  
OE “KCS TRADE ” L.L.C & “TPK OROMETAL”

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP - Qëllimi
- Neni 6 i LPP – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP - Barazia ne trajtim /jo - diskriminim
- Neni 27.4 i LPP – Dosja e tenderit
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies se kontratës
- Neni 41.11 dhe 40.13 i RRUOPP

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Përshkruani rrethanat faktike qe përbejnë supozimin për shkeljen e dispozitave te LPP~ se. Ofroni deklarate te qarte dhe te detajuar për faktet dhe argumentet te cilat mbështesin secilën baze te kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me 03.11.2020, kemi pranuar Vendimin për Refuzimin e Kërkesës per Ri-shqyrtim. Arsyet e refuzimit te Kërkesës për Ri-shqyrtim, pothuajse janë te ngjashme me arsyet e cekura ne Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Tenderuesin e Eliminuar.

Kundërshtojmë fuqishëm, si te paqëndrueshme dhe ne kundërshtim me dispozitat e LPP dhe legjislacionet dytësor për prokurim arsyet e refuzimit te Kërkesës për Ri-shqyrtim, si dhe diskualifikimin e ofertës tone ne Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues per Tenderuesin e Eliminuar, te datës 19.10.2020.



Me datën 19.10.2020, kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Tenderuesin e Eliminuar ku ceket:

#### ARSYETIM

*Ju jeni diskualifikuar për këto arsye:*

*Ju nuk e keni plotësuar kriterin në Nenin III. 2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional në njoftimin për kontratë, apo nën 9.1 & 9.2 në Dosje të Tenderit*

*- Seksioni II. FLETAE TEDHENA VETË TENDERIT (FTD) ku kërkohet Autorizimi nga Prodhuesi i pajisjeve ose dileri i autorizuar nëse autorizimi është nga dileri, atëherë si dëshmi kontratë ose Autorizim mes dilerit dhe prodhuesit për shitjen e produkteve që ofroni", ju mungon autorizimi nga prodhuesi i pajisjeve ose dileri i autorizuar të nxehësve origjinal CASStë këmbyesve NTU- 2 dhe NTU 3.*

*Rezultati i aktivitetit të prokurimit*

*KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. shpërblen me kontratë grupin e Operatoreve ekonomik NTN B & D ENGINEERING & NOVAMAT shpk & Karl Wilhem GmbH, Lidhja e Pejës 69, Prishtinë me vlerë totale të ofertës prej 985.536,00 Euro.*

Një arsyetim i tillë për diskualifikimin e ofertës tone është plotësisht i pa pranueshëm për ne, si dhe nuk ka asnjë bazë ligjore në Ligjin për Prokurimin Publik, në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, si dhe as në vetë Dosjen Tenderike për aktivitetin përkatës të prokurimit, pasi që arsyetimi për diskualifikimin e ofertës tone nuk është i mbështetur në asnjërin nga kërkesat dhe dëshmitë e përcaktuara nga vet AK në nenin 9.1 & 9.2 në DT – Seksioni FLETAE TEDHENA VETË TENDERIT (FTD).

Kundërshtojmë fuqishmen një arsyetim të tillë jo-profesional dhe subjektiv të dhënë nga AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, i cila nuk ka asnjë bazë ligjore, dhe është në kundërshtim të plotë me vetë kërkesat dhe dëshmitë e paracaktuara në Nenin 9.1 & 9.2 - Kërkesa 2 të Dosjen tenderike nga vetë AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a

Në asnjë pikë të kapacitetit teknik dhe ose profesional dhe të dëshmia e kërkuar dokumentare nuk është kërkuar autorizimi nga prodhuesi i pajisjeve, dileri i autorizuar të nxemseve origjinal CASS të këmbyesve NRU-2 dhe NTU-3.

Në kemi ofruar listën me 28 referenca, kurse Listës i kemi bashkangjitur referencat dhe certifikatat për përmbushjen me sukses të punëve në shumë vende të ndryshme të Ballkanit dhe me gjere.

Nëni 27.4 e LPP, Fjalë e fundit: Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. E njëjta kërkesë është obligative për AK edhe sipas Nenit 18.4 të Rregullat dhe Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik.

AK- KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, ofertën tone e ka eliminuar në bazë të një kërkesë e cila nuk është cekur fare në Njoftimin për kontratë dhe në Dosje të Tenderit të Nenit 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Në bazë të kërkesës sipas të ciles na eliminuar neve AK ka qenë e obliguar ta vendosë edhe në ofertën tone duke na eliminuar pa asnjë bazë ligjore, si dhe duke favorizuar një ofertues tjetër të preferuar si dhe duke dëmtuar buxhetin e AK për 204.868,00 Euro. Me këtë veprim mund të konstatohet se AK, paraprakisht është përcaktuar për fituesin e referuar të këtij aktiviteti të prokurimit, por qëllimisht ka përdorë procedurë e hapur me qëllim që të devijoj mjeshtërisht nga trajtimi i barabartë i të gjithë operatoreve ekonomik të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe të vendosë në lajthitje këta OE, si dhe OSHP. OSHP-ja duhet të veproj fuqishëm në këtë rast duke ndaluar një veprim të tillë kundërligjor të



AK- KORPORATA ENERGETIKE KOSOVE Sh.a, si dhe te rekomandoj AK qe ne te ardhmen mos te vepron ne situata te tilla.

Asnjëri nga arsyetimet e dhëna për refuzim të tenderit tone nuk janë parapare fare në Nenin 9.1 & 9.2 të FDT. Ky arsyetim është në kundërshtim të plotë me Nenin 41.11, të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, ku ceket: TENDERUESINUK DO TË DISKUALIFIKOHET OSE PERIASHTOHET NGA PROCEDURAT E PROKURIMIT NË BAZË TË NDONIE KËRKESË PO KITERI QË NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NË NJOFTIMIN E KONTRATËS. DOKUMENTI TENDERIT NË JEMI REFUZUAR NË KUNDËRSHTIM TË PLOTË ME KËTË NEN, SEPSE DËSHMITË E KËRKUARA NË NENIN 9.1 & 9.2, JANË SHUMË TË QARTA DHE KONKRETE, KURSE ARSYEJA PËR ELIMINIM ËSHTË KREJTËSISHT E NDRYSHME ME KËRKESAT DHE DËSHMITË E KËRKUAR,

AK- KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh,a me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me këto nene të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. OS/L-068 dhe Ligjin Nr. OS/L-092: Neni 6 i LPP: Ekonomiciteti dhe efikasiteti.

ARGUMENTIMI AK - KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a\_ka

rekomanduar për Dhënie të Kontratës operatorin ekonomik i cili ka ofruar një çmim me të lartë se sa oferta e jone me një çmim prej 985.536,00 Euro, derisa çmimi i ofertës tone ishte 780.668,00 Euro. Vlera e ofertës tone është më e vogël se sa oferta fituese për 204.868,00 Euro, apo shprehur në përqindje për 26,24 %, që do të thotë se AK ka dëmtuar buxhetin e AK për këtë shumë, edhe pse oferta e jone në çdo aspekt ishte përgjegjshme,

Neni 7 i LPP: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi:

Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

ARGUMENTIMI AK- KORPORATA ENERGETIKE KOSOVE sh.a ka vepruar

në kundërshtim të plotë me këtë nen, duke na diskriminuar haptas, pasi ka propozuar të suksesshëm një operator ekonomik me çmim me të lartë, dhe duke refuzuar ofertën tone me çmim me të ultë, ashtu siç është elaboruar në këtë Kërkesë për Ri-shqyrtim. Neni 59 i LPP: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

ARGUMENTIMI. Komisioni vlerësues i AK - KORPORATA ENERGETIKE KOSOVES sh.a ka rekomanduar për kontratë OE i cili përpos që ka ofruar çmim me të lartë edhe në DT të kriterit për dënimin e kontratës ka përcaktuar çmimin me të ultë.

Të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues të cilët kanë propozuar të suksesshëm një operator ekonomik me një çmim me të lartë marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, Një përgjegjësi e ngjashme bie edhe mbi Zyrtarin Përgjegjës të prokurimit. Neni 59 i LPP-se

ARGUMENTIMI: AK- KORPORATA ENERGETIKE KOSOVES sh.a\_ka refuzuar ofertën tone, edhe pse tenderi jone ishte në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Neni 60 i LPP-se.

ARGUMENTIMI: AK- KORPORATA ENERGETIKE KOSOVES sh.a\_ edhe pse në Dosje Tenderike ka përcaktuar Kriter për Dhënie të Kontratës Çmimin me të ultë, gjatë vlerësimit të ofertave nuk ju ka përmbajtur këtij kriteri. Neni 41.11 i RRUOPP.



ARGUMENTIMI: AK-KORPORATAENERGJETIKE KOSOVESh.a ka refuzuar ofertën tone ne kundërshtim te plote me këtë nen, duke refuzuar ofertën tone ne baze te ndonjë kërkesë apo kriteri qe nuk është specifikuar ne njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Neni 40.13 I RRUOPP.

ARGUMENTIM: Komisioni vlerësues i AK - KORPORATAENERGJETIKE

KOSOVESh.a ka refuzuar ofertën tone e cila ishte me çmim me te ulet, dhe plotësisht e përgjegjshëm, dhe ka rekomanduar per kontrate Operatorin Ekonomik me çmim me te larte. Këtë rekomandim e ka pranuar edhe menaxheri i prokurimit, si person përfundimtar për pranimin apo refuzimin e rekomandimit tre komisionit vlerësues,

Ne rastin konkret përgjegjësia bie mbi anëtarët e Komisionit Vlerësues, si dhe tek Menaxheri i Prokurimit i AK, i cili ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 40.13 te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

Nga e gjithë ecuria e këtij aktiviteti te prokurimit te zhvilluar nga AK-KEK, lehte mund te konstatohet se AK, paraprakisht ka përcaktuar se kush do te jete fitues i këtij tenderi. Kjo mund te vërehet edhe nga Vlera parallogariture e kontratës prej 1.000.000,00 Euro ne krahasim me çmimin e ofruar nga operatori fitues prej 985.536,00 Euro apo vetëm 14.464,00 Euro ndryshim.

Edhe sqarimi i paraqitur ne faqen 25 te Dosjes se Tenderit ne piken: 4 Vëllimi i punëve dhe liferimeve, ku ceket:

*DE duhet te prodhoj tufën e gypave te NTU3 dhe te NTU2, me te gjitha pjesët (flanshen, gypat, përforcuesit, ndarjet etj. plotësisht sipas dizajnit te vjetër. Prandaj DE duhet gjithsesi te këtë ne përbërjen e vete prodhuesin origjinal, ose firmën trashëguese te pronësisë intelektuale te CASS-prodhuesit te këmbyesit NTU.*

Oferta e jone është refuzuar kundërligjshëm dhe pas asnjë baze ligjore, bazuar ne nje konstatim i cili ndodhet diku ne mes te DT dhe e cila qëllimisht është formuluar me qellim qe te favorizoj nje OEt preferuar, dhe per te cilën AK paraprakisht është përcaktuar, por duke i diskriminuar haptas te gjithë OEt tjerë, Ky konstatim i cili nuk është cekur fare si kërkesë obligative as ne Njoftim për Kontrate, dha as ne Dëshmitë e kërkuara ne Neni 9.1 & 9.2, te FDT, është formuluar kështu OEt duhet gjithsesi te këtë ne përbërjen e vete prodhuesin origjinal, ose firmën trashëguese te pronësisë intelektuale te CASS prodhuesit te këmbyesit NTU. Kjo haptas mund te kuptohet se OEi rekomanduar per kontrate, ka qene i bindur se do te jete i vetmi fitues dhe pas asnjë konkurrence, prandaj edhe ka ofruar çmimin përafërsisht te njëjtë me vlerën para llogaritare te kontrate.

Me qellim qe OSHP te këtë një pasqyre me te qarte lidhur me këtë shtate te mjegulluar qëllimisht nga vete AK, ne dëshirojmë ta njoftojmë OSHP-ne se nuk ekziston fare firma origjinale CASS pasi qe kjo firme është shuar para disa dekadave, por ne mënyrë fiktive paraqitet vetëm një inxhinieri cili pretendon se ka pronësinë intelektuale, i cili nuk ka asnjë baze ligjore për këtë, por dhe i cili i manipulon me AK dhe me OE tjerre me disa vizatime te pavlere, qe për një prodhues serioz siç është TPK OROMETAL janë krejtësisht te pa rëndësishme.

Ky kriter nuk është vendosur fare ne Dëshmitë e kërkuara ne Neni 9.1 & 9.2, te FDT, kurse mu për këtë është refuzuar oferta jone, qe mund te konstatohet se AK, paraprakisht ka përcaktuar se kush do te jete fitues i këtij tenderi, deri sa ofertën tone e ka refuzuar ne baze te nje kërkesë e cila nuk ndodhe fare ne Dëshmitë e kërkuara ne Neni 9.1 & 9.2, te FDT.

Ne ofertën tone kemi ofruar te nënshkruar dhe te vulosur DEKLARTATENE SPECIFIKACIONITTEKNIK- Neni 3 ku vërtetojmë se: NE përmbushim kërkesat e detyrueshme teknike dhe se oferta e jone është plotësisht ne përputhje me kërkesat tuaja sipas ANEKS 1 dhe Pjesës II te Formularit për Dorëzimin



e Tenderit, Përshkrimin e çmimeve si ne vijim: (shiko Shtojcën e bashkangjitur Kërkesës për Rishqyrtim).

Duke u bazuar ne te dhënat e cekura me larte, kërkojmë nga OSHP:

Te shqyrton te gjitha pretendimet e Ankese sonë, te bien Vendimin meritor duke u bazuar ne faktet dhe argumentet e konstatuara, si dhe te kërkon RI- VLERËSIMIN e këtij Tenderi, si dhe eliminimin e shkeljeve te bëra nga AK gjate ri-vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit.

Dikush duhet te merre përgjegjësinë ligjore, disiplinore dhe penale për veprimet kundërligjore ne rastin konkret. Duke mos pasur asnjë mundësi ligjore për eliminimin e kompanisë tone, pasi qe kemi plotësuar te gjitha kërkesat dhe kemi ofruar çmimin me te lire ne përputhje ke kriterin për Dhënie te Kontratës: CMIMI MEI LIRE, në rastin konkret AK na ka dëmtuar neve si tenderues dhe ka favorizuar një ofertues tjetër.

Duke pasur një besim te plote ne OSHP, shpresojmë se Kërkesa e jone për Rishqyrtim do te vlerësohet drejte, dhe ne përputhje me Nenin 1 te LPP:

Qëllimi i Ligjit. Ne te kundërtën do te jemi te detyruar qe te drejtën tone ligjore dhe te patjetërsueshme ta kërkojmë ne Institucionet përgjegjëse te Kosovës qe merren me zbatimin e LPP si dhe ne organet kompetente gjyqësore te Kosovës.

#### **KRITERET PËR VLERËSIM**

Te vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Arsyeja e eliminimit te OE ankues është për shkak se nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit te pika 9.1 & 9.2. ku është kërkuar Autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per shitjen e produkteve qe ofrohen.

#### **RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES**

**Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:**

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës se OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE ankues është vlerësuar si tenderues i pa përgjegjshëm dhe është e eliminuar.

#### **INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK**

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

#### **VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së**

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

#### **VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME**

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjti është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit.

#### **ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME**

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.



## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "KCS TRADE L.L.C & TPK OROMETAL"

### Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka refuzuar ofertën tone kundërligjshëm dhe pas asnjë baze ligjore për mos përmbushjen e kërkesës në Nenin 9.1 & 9.2, të FDT që ka të bëjë me *"Autorizim nga prodhuesi i pajisjeve ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni"* edhe pse në për këtë pikë kemi ofruar si dëshmi "Autorizimi (Deklarata) e prodhuesit të pajisjeve të kërkuara "TOK OROMETAL" i cili prodhues është pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit si anëtar i konzorciumit, ekspertit shqyrtues ka këtë mendim.

Operatori ekonomik ankues në ofertën e tij lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për ofrimin e Autorizimit të prodhuesit për shitjen e produkteve që ofroni, ka dorëzuar një Deklaratë të prodhuesit "TPK OROMETAL" nga shteti i Kroacisë i cili prodhues është edhe anëtar i konzorciumit të operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit. Pra vet prodhuesi ka bashkangjitur me ofertë deklaratën për këtë aktivitet të prokurimit me të cilin deklaron se produktet e kërkuara do të prodhohen në fabrikën tone sipas konfirmimit të CE. Pra ky dokument për mendimin e ekspertit shqyrtues e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit (si kriter i përzgjedhjes) sepse vetë prodhuesi merr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit. Ky prodhues është nga vendet e bashkimit evropian dhe prodhon produkte me çertifikatë të konformitetit CE të cilat standarde prodhimi lejohen për përdorim në shtete të BE-së e me teje. Përshkrimi i dhënë në dosjen e tenderit nga ana e autoritetit kontraktues që është marrë si baze për eliminimin e OE ankues i cili thotë:

*"OE duhet të prodhojë tufën e gypave të NTU3 dhe të NTU2, me të gjitha pjesët (flanshën, gypat, përforcuesit, ndarjet etj. plotësisht sipas dizajnit të vjetër. Prandaj OE duhet gjithsesi të ketë në përbërjen e vetë prodhuesin origjinal, ose firmën trashëguese të pronësisë intelektuale të CASS – prodhuesit të këmbjesit NTU".*

Për mendimin e ekspertit shqyrtues është çështje të cilën zgjidhjen teknike duhet ta bëjë vetë prodhuesi dhe për këtë OE ankues ka ofruar edhe deklaratën e specifikimeve teknike që produktet ofrohen sipas specifikimit teknike të kërkuar nga AK. Pra nuk mundet të jete baze për eliminim kjo çështje kur zgjidhjet teknike tani janë të mundshme nga me të ndryshmet. Prodhuesi CASS i këmbjesit të nxehtësisë të cilit janë të montuar tani në KEK, ka mbyllur veprimtarinë. Zgjidhjet teknike tani janë të mundshme për zëvendësimin e produkteve të vjetëra të cilat i ka KEK. Është e pa kuptimtë që produktet e një prodhuesi nga vendet e bashkimit evropianë të janë të pa pranueshme për vendin tone. Mbi këtë baze ekspertit shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të bazuar.

### MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe ka eliminuar OE ankues si tenderues i pa përgjegjshëm për mungesë të autorizimit të prodhuesit edhe pse OE ankues ka aplikuar me një prodhues i cili vjen nga shtetet e bashkimit evropian dhe i njëjti ka ofruar dëshminë për plotësimin e kërkesës së DT-së. Pra nga AK nuk janë respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 të LPP-së. Është rekomanduar për kontratë OE i cili ka dhënë ofertën me **çmim me të lartë mbi 204.000,00 € se oferta e OE ankues**. Pra nga kjo rezulton se nuk është respektuar edhe kriteri i dhënie së kontratës, respektivisht neni 60 i LPP-së.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të **aprovohet** si e **bazuar**. Ekspertit shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **bëjë Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbjesve të nxehtësisë 2 dhe 3"** me nr. të prok. **KEK-20-776-511** në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues KEK, Panelit Shqyrtues OSHP dhe OE "KCS TRADE L.L.C & TPK OROMETAL"

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "KCS TRADE L.L.C & TPK OROMETAL" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbjesve të nxehtësisë 2 dhe 3" me nr. të prok. KEK-20-776-511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës.